



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

STRATEGJIA PËR MIGRIM

2021-2025

RAPORTI VJETOR PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT

Qershor, 2023

HYRJE

Strategjia për Migrim 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.10/39, të datës 13 Tetor 2021. Pas raportit të parë të finalizuar në muajin Qershor 2022, ky është raporti i dytë mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë. Si i tillë raporti përfshin periudhën kohore përgjatë gjithë vitit 2022 deri me datë 31 Maj 2023. Metodologjia e hartimit së raportit dhe struktura e tij, është bazuar në Manualin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike të hartuar nga Zyra për Planifikim Strategjik.

Në përputhje me Shtojcën 1.6 të Strategjisë, lidhur me aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Strategjisë, ky raport është pregaditur nga Sekretariati i Autoritetit Qeveritar për Migracion në bashkëpunim me Sekretariatën e Strategjive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera shtetore të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë. Në këtë kontekst, të gjitha institucionet kanë ofruar të dhënat lidhur me progresin e arritur dhe sfidat përkitazi me zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë.

PROGRESI I PËRGJITHSHËM

Strategjia për Migrim 2021-2025 është e organizuar në 4 objektiva strategjike, 15 objektiva specifike dhe 91 masa implementuese. Në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, të dhëna këto të cilat janë përpunuar dhe validuar në përputhje me treguesit e rezultatit (outputit,) mund të konstatohet se nga **91 veprime të planifikuara, 32 prej tyre ose 35% janë zbatuar plotësisht, 48 veprime ose 54 % janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 10 veprime ose 11 % nuk janë zbatuar.**

Sa i përket fushave të cilat tregojnë performancën më të mirë, mund të konstatohet se në objektivat specifike *1.2. Avancimi i politikave dhe sistemit për riintegrimin e qëndrueshëm të migrantëve të kthyer; 1.3. Zhvillimi i politikave dhe skemave që synojnë menaxhimin e imigrimit për qëllime të punësimit dhe krijimi i lehtësirave për tërheqjen e imigrantëve me kualifikime bazuar në nevojat e tregut të punës; 3.1 Rishikimi i sistemit aktual të migrimit të brendshëm dhe 4.1. Fuqizimi i rolit të AQM-së,* mund të konstatohet se ka pasur më shumë progres ndërsa në fushat tjera disa nga rezultatet e arritura janë inkurajuese por për shkak të vonesave dhe vështirësive të ndryshme është pamundësuar zbatimi i plotë i veprimeve të parapara.

SFIDAT NË ZBATIM

Sa i përket sfidave në zbatim në disa raste kemi pasur ngecje në dinamikë nga ana e institucioneve zbatuese, por në shumicën e veprimeve sfidat kanë qenë të natyrës objektive, duke u nisur nga ngrirja e procesit të rekrutimit të zyrtarëve të rinj në kuadër të administratës publike, pastaj tërheqjes së të gjitha akteve nënligjore nga Plani i akteve nënligjore me qëllim të krijimit të bazës së mirëfilltë ligjore, pastaj vonesat në komunikimin përmes kanaleve diplomatike lidhur me negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale etj. Poashtu duhet të nënvizohet fakti se aktivitetet të cilat ndërlidhen me objektivin 2.1 Informimi i qytetarëve të Kosovës për rregullat e hyrjes dhe qëndrimit në zonën Schengen, përkundër faktit se të gjitha aktivitetet/produketet e planifikuara janë pregaditur, ekzekutimi i tyre është shtyrë për tre mujorin e fundit të vitit 2023 dhe fillimin e vitit 2024 për të qenë në koherencë me hyrjen në fuqi të regjimit pa viza në vendet e Zonës Schengen, përkatsisht më 1 Janar 2024. Ndërkohë, në disa veprime nuk kemi pasur asnjë lëvizje sa i përket zbatimit dhe si të tilla, rekomandohet të ri-shikohen dhe eventualisht të zëvendësohen me aktivitete tjera.

HAPAT E ARDHSHËM

Ky raport do të shërbejë si instrument matës i vlerësimit të gjendjes aktuale sa i përket zbatimit të Strategjisë së Migrimit 2021-2025. Në bazë të të gjeturave dhe në konsultim me institucionet zbatuese, Autoriteti Qeveritar për Migracion ka identifikuar një listë me fushat kryesore ku ka pasur ngecje dhe ku kërkohet një dinamikë e shtuar me qëllim të zbatimit të të gjitha veprimeve të planifikuara. Poashtu përmes Koordinatorit Nacional për Migrim do të propozohen zgjidhjet e mundshme për problemet e identifikuara dhe hapat e ardhshëm drejt zbatimit të Strategjisë.

Në bazë të progresit të deritanishëm, Autoriteti Qeveritar për Migracion, do t'i rekomandoj Koordinatorit Nacional për Migrim, të inicioj procesin e përditësimit të Planit të Veprimit të Strategjisë së Migrimit për periudhën 2023-2025.

Nr.	Objektivat dhe Veprimet	Afati i fundit	Burimi i Financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (output)	Dokumenti Referues	Progresi në zbatim
1.	Objektivi Strategjik	Menaxhimi i Migrimit të Rregullt					
1.1	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Menaxhimi i procesit të migrimit të rregullt</i>					
1.1.1	Inicimi dhe arritja e marrëveshjeve bilaterale ndër-shtetore në fushën migrimit të rregullt (migrimi qarkor/sezonal për çështje punësimi, studimi, zhvillimi të shkathësive dhe mundësimit të lëvizshmërisë /mobilitetit)	2021 - 2023	BK	MFPT APRK MPJD MPB	Inicimi dhe arritja e 3 marrëveshjeve bilaterale në fushën e migrimit të rregullt	Plani i Punës së MFPT	<p>Deri më tani është realizuar Memorandumi i Mobilitetit me Shqipërinë dhe janë mbajtur disa takime të përbashkëta në nivel të grupeve punuese me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mundësinë e punësimit të punëtorëve nga secili shtet në territorin e shtetit tjetër. Takimi i rradhës ku do të diskutohen aspekte praktike të bashkëpunimit është planifikuar të mbahet me 17-18 Qershor 2023.</p> <p>Poashtu janë inicuar edhe marrëveshjet bilaterale në fushën e migrimit të rregullt dhe mobilitetit me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Takimi i parë është mbajtur me 27 Maj 2023 në Shkup, ndërsa me 7-8 Qershor 2023 pritet të mbahet takimi në Podgoricë.</p>
1.1.2	Emërimi dhe dërgimi i Atasheve për Migrim në vendet me interes për bashkëpunim në fushën e migrimit	2021 - 2023	BK	MPB MPJD	Brenda periudhës 2021-2023 do të emërohen dhe vendosen 3 Atashe për Migrim në kuadër të misionëve	Ligji për të Huaj Marrëveshja në mes MPJD-MPB	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti. Në Planin e Veprimit 2023-2025 propozohet të rishikohet ky aktivitet dhe fillimisht të bëhet një analizë/fizibilitet para se të vendoset tutje për emërimin dhe dërgimin e Atasheve për Migrim në vendet me interes.

					diplomatiqe të Republikës së Kosovës		
1.1.3	Ngritja e kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve për migrim	2021 - 2022	GIZ/DIMAK	MFPT	20 zyrtarë të trajnuar lidhur me ofrimin e shërbimeve për migrim	Analiza e vlerësimit të nevojave	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës me mbështetjen e GIZ-in dhe Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë (DIMAK) ka realizuar disa trajnime për 20 zyrtarët e Divizionit të Shërbimeve të Migrimit dhe Zyrat e Punësimit të cilët merren me shërbimet e Migracionit. Zyrtarët janë trajnuar në këto fusha: -Përdorimi i Manualeve për Migracionin e Punës në 5 Vende të BE-së; -Orientimi në Karrierë; -Njohja me Rregulloret e BE-së; -Monitorimi dhe Vlerësimi; -Shkrimi i raportit; -Njohuri mbi proceset e migrimit; -Hartimi i dokumentit informativ të politikave; -Hartimin e politikave të migrimit për çështje punësimi etj.
1.1.4	Ofrimi i shërbimeve informuese dhe këshilluese për migrim përpara nisjes për punëtorët migrantë potencial.	2021 - 2023	BK	MFPT	Ofrimi i 5 pakove informuese në 7 zyrat të punësimit		Në vitin 2019 janë pregaditur 5 pako informuese (Gjermani, Kroaci, Zvicërr, Austri dhe Slloveni) të cilat u janë shpërndarë Zyrave të Punësimit. Sidoqoftë, duke qenë se legjislati në vendet e BE-së në fushën e migrimit të rregullt është duke ndryshuar në vazhdimësi edhe pakot informuese duhet të përditësohen. Duke qenë se Agjencia e Punësimit dhe Aftësive e Republikës së Shqipërisë i publikon në kohë reale të gjitha informatat për të gjitha shtetet e BE-së, në kuadër të bashkëpunimit dhe marrëveshjes së mobilitetit, po shiqohen mundësitë që të marrim këto

							informata dhe të njejtat të prezentohen në zyrat rajonale të punësimit, por edhe të publikohen në ndonjërin nga platformat aktuale apo ato që do të krijohen në të ardhmën si në Sistemin Informativ të Punësimit apo faqen zyrtare të APRK-së dhe AQM-së.
1.1.5	Zhvillimi i shkathtësive profesionale të qytetarëve të Kosovës të cilët synojnë tregun e punës në vendet e BE-së	2021 - 2023	GIZ DIMAK	MFPT	Rritja e numrit të përfituesve të shërbimeve të edukimit dhe aftësimin profesional për 30% (nga numri aktual 120)	Plani i Punës MFPT	Tek të gjithë përfituesit e shërbimeve të Zyreve të Punësimit dhe Qëndrave të Aftësimeve Profesionale të cilët kanë qenë të interesuar për punë jashtë vendit, mirëpo të dhënat për numrin e përfituesve nuk mund të gjenerohen për shkak se moduli për emigrim (punëkërkuarit potencial të cilët synojnë punësimin në tregun e jashtëm të punës) në kuadër të Sistemit Informativ të Punësimit është jo funksional.
1.1.6	Ngritja e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë	2021 - 2022	BK	MFPT	3 zyrtarë përgjegjës të emëruar dhe trajnuar për monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë		Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti. Për më tepër në Planin e Veprimit 2023-2025, rekomandohet të ri-formulohet ky veprim për shkak se fokusi fillimisht është tek lidhja e marrëveshjeve bilaterale në fushën e migrimit të rregullt, në mënyrë që të kemi të dhëna të sakta për numrin e punëtorëve migrantë dhe sektorët në të cilët do të punojnë, në mënyrë që të ushtrojmë përgjegjësinë për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
1.2	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Avancimi i politikave dhe sistemit për riintegrimin e qëndrueshëm të migrantëve të kthyer</i>					
1.2.1	Regjistrimi i të gjithë personave të ripranuar në momentin e arritjes në PKK	2021 - 2023	BK	PK	Të gjithë personat e ripranuar regjistrohen në Sistemin për Menaxhimin e Kufirit		Të gjithë personat e riatdhesuar regjistrohen në Sistemin për Menaxhimin e Kufirit (BMS) dhe në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (SMR). Gjatë vitit 2022 dhe periudhën raportuese Janar-Mars 2023 janë pranuar 702 persona të riatdhesuar në Qendrën e Pritjes së Persoave të riatdhesuar në Aeroportin

							Ndërkombëtar të Prishtinës, pikat tjera kufitare si dhe në Zyret Komunale për Kthim dhe Komunitete.
1.2.2	Avancimi i sistemit të informimit, këshillimit dhe referimit të rasteve nga momenti i arritjes në PKK	2021 - 2023	BK	MPB	Të gjithë personat e riatdhesuar informohen dhe këshillohen për të drejtat, mundësitë dhe detyrimet në procesin e riintegritit dhe ata marrin shërbimet përkatëse profesionale, te nevojshme për riintegrimin e qëndrueshëm të tyre	Rregullorja për Riintegrimin e personave të riatdhesuar QRK 22/2020 Pakti Global për Migrim	Të gjithë personat e riatdhesuar informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre që ofrohen nga zyrtarët përkatës edhe përmes, fletëpalosjeve informative në gjuhën Shqipe, Serbe, Turke, Rome, Gjermane dhe Angleze të cilat janë në dispozicion, dhe u shpërndahen personave të riatdhesuar me qëllim të informimit për të drejtat dhe mundësitë e përfitimit në skemat e riintegritit. Gjatë vitit 2022 dhe në periudhën raportuese Janar - Mars 2023 janë mbështetur në skemat e ndryshme për riintegrim 3987 persona të riatdhesuar të ri dhe të bartur nga vitet paraprake, të cilët kanë përfituar nga DRPRIH/Buxheti i Riintegritit, institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare të cilat mbështesin procesin e riintegritit.
1.2.3	Avancimi i menaxhimit të rasteve përmes qasjes individuale të të kthyerve bazuar në nevoja	2021 - 2023	BK	MPB Komunitat	Nevojat specifike të personave të ripranuar kuptohen dhe adresohen sipas nevojave të tyre	Rregullorja për Riintegrimin e personave të riatdhesuar QRK 22/2020 Pakti Global për Migrim	Personave të riatdhesuar pas vendosjes në komunën e origjinës, ju bëhet verifikimi 72 orësh ku bëhet edhe identifikimi i nevojave fillestare si dhe verifikimet tjera sipas kërkesës që paraqet për përfitim në skemat e riintegritit sipas legjislacionit në fuqi. Përgjatë periudhës raportuese janë monitoruar dhe verifikuar 5862 persona/familje.

1.2.4	Sigurimin e shërbimeve psikologjike e psiko-sociale dhe shërbimeve të tjera këshilluese për grupet e cënueshme, fuqizimin ekonomik, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale në komunitet	2021 - 2023	BK GIZ	MPB MFPT MSH	<p>Riintegrimi i qëndrueshëm i personave të cënueshëm.</p> <p>Anëtarët e komunitetit mbështesin migrantët e kthyer për ri integrimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të tyre dhe ndikojnë në përmirësimin e rezultateve të ri integrimit dhe reflektojnë respektin e ndërsjellë</p>	<p>Rregullorja për Riintegrimi n e personave të riatdhesuar QRK 22/2020</p> <p>Pakti Global për Migrim</p>	<p>Personat e riatdhesuar dhe ata të cilët janë të kategorizuar si grupe të cënueshme u ofrohen shërbime psikologjike, psiko sociale sipas nevojës si dhe shërbime të tjera që ofrohen nga institucionet vendore dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që e mbështesin procesin e riintegrimit. Përgjatë periudhës raportuese 413 personave të riatdhesuar u janë ofruar shërbimet psiko-sociale.</p>
-------	--	-------------------	---------------	--------------------	---	--	---

1.2.5	Fuqizimin e kapaciteteve komunale, koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional	2021 - 2023	BK GIZ	MPB MFPT MASHTI MSH MKRS MAPL GIZ UNDP Komunat Shoqëria Civile	Kapacitete adekuate për zbatimin e politikave të riintegrit, në partneritet me të gjithë akterët relevant, si dhe Ndërmarrja e veprimeve në mënyrë të koordinuar e të integruar brenda sistemit shtetëror të riintegrit	Rregullorja për Riintegritin e personave të riatdhesuar QRK 22/2020 Pakti Global për Migrim	<p>Niveli lokal dhe qendror janë trajnuar në vazhdimësi për procesin e riintegrit. Me qëllim të finalizimit të Manualit dhe Doracakut Praktik, gjatë muajit Mars 2022 janë realizuar tetë (8) punëtori në nivel lokal dhe një (1) në nivel qendror, të organizuara në shtatë (7) regjione të Kosovës, me pjesëmarrjen e 143 zyrtarëve, të mbështetur nga GIZ-i. Në kuadër të këtyre punëtorive janë mbledhur inputet për hartimin e ‘Manualit për Menaxhimin e Rrezikut për riintegritin e qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë’ dhe ‘Doracakut Praktik – Identifikimi i rreziqeve dhe planifikimi për menaxhimin e tyre, për Riintegrit të qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë’.</p> <p>Gjatë vitit 2022 dhe periudhës Janar – Mars 2023, me qëllim të përditësimit dhe krijimit të Planeve të Veprimit Komunal për Riintegrit 2023 -2025, DRPRIH ka trajnuar gjithsej 284 zyrtar komunal, ndërsa janë organizuar edhe shtatë (7) tryeza të rrumbullakëta për zhvillimin e Planeve të Veprimit Komunal për Riintegrit me pjesëmarrjen 114 zyrtarëve komunal si dhe në bashkëpunim me Caritasin Zvicran në Kosovë janë organizuar (6) punëtori rajonale për finalizimin e Planeve të Veprimit Komunal për Riintegrit me pjesëmarrjen e 170 zyrtarëve komunal.</p> <p>Sa i përket Planeve të Veprimit Komunal për Riintegrit janë finalizuar 38 prej tyre, ndërsa deri me tani janë aprovuar 8 Plane të Veprimit Komunal për Riintegrit. Pas miratimit të planeve, do të vazhdohet me trajnimet e zyrtarëve përgjegjës në nivel lokal për zbatimin e tyre.</p>
-------	---	-------------------	---------------	--	---	--	--

							Gjatë muajit Mars 2023 janë certifikuar pesë (5) zyrtarë të DRPRIH-së në Trajnimin për Trajner (TOT) me temën "Puna me Migrant, Refugjat, të Rikthyer dhe të Riatdhesuar në Kosovë" i mbështetur nga projekti Mbështetja e ri/integrimit socio-ekonomik dhe sigurimi i të drejtave të barabarta të pjesëmarrjes për gratë dhe vajzat e riatdhesuara dhe refugjate në Kosovë.
1.2.6	Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave të ripranuara	2021 - 2023	BK GIZ	MPB MFPT MASHTI MAPL GIZ UNDP Komunat Shoqëria Civile	Trajtimi i barabartë gjinor dhe parandalimi i diskriminimit të grave dhe vajzave	Rregullorja për Riintegrimin e personave të riatdhesuar QRK 22/2020 Pakti Global për Migrim	<p>Të gjithë personat e riatdhesuar në procesin e riintegrit trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinie, me fokus të veçantë Nënat Vet-Ushqyese. Nga skemat e ndryshme për Riintegrim, gjatë vitit 2022 dhe periudhës Janar-Mars 2023 kanë përfituar gjithsej njëqind e pesëdhjetë e një (151) familje me katërqind e njëmbëdhjetë (411) anëtar, prej tyre 49 familje janë të kategorizuara si nëna (prind) vet-ushqyese, të cilat janë mbështetur në skemat e ndryshme për riintegrim akomodimin me qera, pako ushqimore dhe higjienike, pako dimërore etj.</p> <p>Në kuadër të projektit 'Mbështetja e ri/integrimit socio-ekonomik dhe sigurimi i të drejtave të barabarta të pjesëmarrjes për gratë dhe vajzat e riatdhesuara dhe refugjatë në Kosovë' të mbështetur nga organizatat ndërkombëtare, për periudhën raportuese Janar-Mars 2023, janë mbështetur 18 vajza/gra me shërbime të ndryshme psikologjike, këshillime juridike, pako shëndetësore dhe aktivitete sociale. Ndërsa dy (2) vajza/gra kanë përfituar mbështetje me trajnime profesionale dhe një (1) vajzë është mbështetur me pagesë të qirasë të biznesit.</p>

1.2.7	Promovimi i të drejtave të fëmijëve, dhe aplikimi i parimit të Interesit më të mirë të fëmijës gjatë gjithë procesit të riintegrit	2021 - 2023	BK GIZ	MPB MFPT MASHTI MAPL GIZ UNDP Komunat Shoqëria Civile	Mbrojtja dhe rintegrimi i qëndrueshëm i fëmijëve të riadhesuar, me fokus fëmijëve të pashoqëruar	Rregullorja për Riintegrimi n e personave të riadhesuar QRK 22/2020 Pakti Global për Migrim	Të gjithë personat e riadhesuar në procesin e riintegrit trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim e më fokus të veçante fëmijët e pa shoqëruar, gjithmonë duke marr parasysh interesin më të mire të fëmijëve në të gjitha fazat e riintegrit. Në skemat e ndryshme për riintegrim për vitin 2022 dhe periudhën Janar - Mars 2023 kanë përfituar kurse të gjuhës (mësim plotësues) 257 nxënës, ndërsa 351 fëmijë janë asistuar në shkolla pas riadhesimit.
1.3	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Zhvillimi i politikave dhe skemave që synojnë menaxhimin e imigrimit për qëllime të punësimit dhe krijimi i lehtësirave për tërheqjen e imigrantëve me kualifikime bazuar në nevojat e tregut të punës</i>					
1.3.1	Vlerësimi i legjislacionit relevant për punësimin e të huajve në Republikën e Kosovës	2021	Donatorët MIMAK - SDC DIMAK – GIZ	MPB MFPT MJD PK	1 Vlerësim i përfunduar	Koncept Dokumenti për të Huajt	Është kryer vlerësimi dhe është përfshirë si pjesë integrale e Koncept Dokumentit për të Huajt.
1.3.2	Vlerësim/analizë për përcaktimin eventual të kuotave vjetore për punësimin e të huajve dhe ri-përcaktimin e mekanizmit institucional për dhënie të lejeve të punës	2021 - 2022	BK, GIZ/DIMAK	MFPT MPB	1 Studim/hulumtim i finalizuar	Koncept Dokumenti për të Huajt	Në Projektligjin e ri për të Huajt është paraparë vendosja e kuotës vjetore të punësimit për të huajt e cila propozohet nga MFPT (duke marrë për bazë rekomandimet e Këshillit Ekonomiko-Social) dhe miratohet nga Qeveria. Kuota vjetore e punësimit do të përcaktohet në harmoni me politikën e migrimit dhe gjendjen në tregun e punës. Me kuotën vjetore për punësimin e të huajve, do të përcaktohen veprimtaritë dhe profesionet në të cilat lejohet punësimi i ri, si dhe numri i lejeve për secilën veprimtari dhe profesion.

1.3.3	Vlerësimi për Decentralizimin dhe digjitalizimin e sistemit të lejeve të punës	2021 - 2023	GIZ DIMAK	MFPT	1 Modul i zhvilluar dhe funksional për decentralizimin e lejeve të punës dhe integrimin e bazës së të dhënave DSHAM-MFPT	Koncept Dokumenti për të Huaj	Është realizuar vlerësimi për decentralizimin dhe digjitalizimin e sistemit të lejeve të punës, por ende nuk ka nisur për tu decentralizuar tek Zyrat e Punësimit.
1.3.4	Zhvillimi i masave që kanë për qëllim lehtësimin e qasjes në tregun e punës për migrantët me aftësi specifike.	2021	BK	MFPT	1 vlerësim i nevojave të tregut të punës Dokument për propozim të masave lehtësuese për imigrantët me aftësi specifike		APRK në me mbështetje të GIZ/DIMAK aktualisht është duke kryer hulumtimin mbi ndikimin e emigrimit në tregun vendor të punës në vend dhe në bazë të rezultateve dhe analizës së dalur nga hulumtimi i cili do të fokusohet kryesisht tek sektori privat, do të propozoj edhe zhvillimin e masave perkatëse lehtësuese. Njëkohësisht, në Projektligjin e ri për të Huajt janë paraparë disa masa të cilat kanë për qëllim lehtësimin e qasjes në tregun e punës për migrantët me kualifikim të lartë. Njëra ndër këto masa është edhe aplikimi i Kartës së Kaltërt RKS, sipas praktikës së aplikuar në shtetet anëtare të BE-së.
1.4	Objektivi specifik	<i>Fuqizimi i sistemit për integrimin e të huajve</i>					
1.4.1	Harmonizimi i politikave sektoriale me politikat shtetërore të integrimin të të huajve	2021 - 2022	BK	MPB MFPT MSH MASHTI MAPL MKRS UNHCR	5 politika sektoriale të harmonizuara me politikat e integrimin të të huajve	Rregullorja për Integrimin e të Huajve QRK 09/2019	Përgjatë periudhës raportuese janë harmonizuar disa politika relevante për integrimin e të huajve: Janë harmonizuar politikat me MFPT për ndihmën sociale për Integrimin e të Huajve; pastaj MSH ka mbështetur të huajt lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore, MASHT-i për integrimin e të huajve në Arsim, si dhe UNHCR ka mbështetur integrimin në të gjitha fushat duke përfshirë edhe ndihmën juridike.

1.4.2	Realizimi i trajnimeve për stafin në nivel qendror dhe lokal në fushën e integritit të të huajve	2021 - 2023	GIZ UNHCR	MPB Komunat UNHCR/CR PK	21 trajnime të mbajtura për nivelin qendror dhe lokal lidhur me integrimin e të huajve	Plani Strategjik për ngritjen e kapaciteteve e 2021-2023	<p>Janë duke u zbatuar masat për mbështetjen e personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe më qellim të ngritjes se kapaciteteve dhe zbatimit të politikave për Integrimin e të Huajve.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe janë certifikuar dhjetë (10) persona, prej tyre katër (4) zyrtarë janë të DRPRIH-së në Trajnimin për Trajner (TOT) për Integrimin e të Huajve të organizuar nga IKAP-I, të mbështetur nga Projekti “KSV/019 Mbështetje Teknike në Kontekst të Integritit Evropian të Kosovës.</p> <p>Është aprovuar “Udhëzuesi për Procedurat Standarde të Veprimit për Integrimin e të Huajve në RKS’ dhe për zbatimin e këtij udhëzuesi MPB/DRPRIH në bashkëpunim me UNHCR-in dhe Programin për të drejtat civile në Kosovë (CRP/K), ka realizuar gjashtë (6) punëtori në nivel lokal të organizuar në gjashtë (6) rajone të Republikës së Kosovës, më pjesëmarrjen e njëqind e katërbëdhjetë (114) zyrtarëve komunal.</p> <p>Është aprovuar "Udhëzuesi për Qasjen e të Huajve në Aftësim Profesional dhe Punësim", për finalizimin e tij janë realizuar dy (2) punëtori më pjesëmarrjen e tridhjetë e tetë (38) zyrtarëve të institucioneve vendore dhe organizatave ndërkombëtare, të mbështetur nga Caritasi Zviceran.</p> <p>Për implementimin e Udhëzuesit për Qasjen e të Huajve në Aftësim Profesional dhe Punësim janë realizuar katër (4) punëtori më pjesëmarrjen e 90 zyrtarëve të nivelit qendror dhe lokal në gjashtë (6)</p>
-------	--	-------------	--------------	----------------------------------	--	--	--

							<p>rajone, të përbërë nga akterët kryesor për integrimin e të huajve.</p> <p>Janë hartuar tridhjetë e tetë (38) Planet Lokale të Veprimit për Riintegrim dhe Integrim 2023 -2025 të cilat janë në proces të aprovimit nga Kuvendet Komunale, ndërsa pas aprovimit të tyre do të realizohen trajnimet përkatëse për zbatimin e tyre.</p>
1.4.3	Avancimi dhe promovimi i partneritetit shumëpalësh	2021 - 2023	BK	MPB Komunat Avokati i Popullit UP OEK Shoqëria Civile dhe Mediat Donatorët (UNHCR, GIZ, JRC)	6 Takime të përbashkëta me partnerët Institucional, Shoqërinë Civile dhe Donatorët	Rregullorja për Integrimin e të Huajve QRK 09/2019	Me qëllim të avancimit dhe zbatimit të politikave për integrimin e të huajve, janë realizuar takime informuese dhe koordinuese me institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin procesin e integrimin të huajve.
1.4.4	Avancimi i rrjetit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e integrimin të të huajve	2021 - 2023	GIZ	MPB	Pjesëmarrja në 6 iniciativa/forume rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e integrimin të të huajve	Rregullorja për Integrimin e të Huajve QRK 09/2019	Në kuadër të zhvillimit, shkëmbimit të përvojave dhe avancimit të politikave për integrimin e të huajve, përgjatë periudhës raportuese janë realizuar 4 vizita studimore në shtetin e Zvicrës, Bosnje Hercegovinë, Holandë dhe Shqipëri.

1.4.5	Këshillimi dhe mbështetja e të huajve në procesin e integritit bazuar në qasjen individuale	2021 - 2023	BK	MPB UNHCR JRS	<p>4 forume këshilluese me të huajt të organizuara</p> <p>Ofrimi i kurseve të integritit për 100 persona të huaj</p> <p>Sigurimi i ndihmës së nevojshme, kujdesit shëndetësor, shërbimeve psikologjike e psiko-sociale dhe shërbime të tjera këshilluese për 50 persona të huaj me fokus në grupet e cenueshme</p>	<p>Rregullorja për Integritimin e të Huajve QRK 09/2019</p> <p>Pakti Global për Migrim</p> <p>Pakti Global për Refugjatë</p>	<p>Të gjithë të huajt të cilët marrin statusin e mbrojtjes ndërkombëtare ju bëhet vlerësimi i nevojave si dhe informohen lidhur më të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me skemat e përfitimit, duke u informuar më fletëpalosjet informative ne gjuhën të cilën ata e kuptojnë.</p> <p>Gjatë vitit 2022 dhe periudhës Janar – Mars 2023, në skemat e ndryshme për integrim janë mbështetur persona me status të mbrojtjes ndërkombëtare, 13 gazetarë nga Ukraina, si dhe 5 gazetarë nga Afganistani te cilët kanë përfituar skema të ndryshme për integrim nga Departamentit për Ri intergimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integritimin e të Huajve (DRPRIH), Programet e Qeverisë dhe organizatat ndërkombëtare qe mbështetjen, zhvillimin e politikave të integritimit.</p> <p>Procesi dhe skemat e integritit monitorohen dhe vlerësohen në vazhdimësi dhe gjatë kësaj periudhe kanë përfituar 33 persona në skemën e akomodimit me qira, pako ushqimore 71 persona, shërbime shëndetësore 33 persona, pako higjienike 32 persona, kurse të gjuhës 23 persona, ndihmë juridike falas 25 persona, trajtim psiko-social 15 persona, punësim dhe aftësim profesional 4 persona, vlerësim i nevojave 33 persona, shkollim 12 persona, ndihmë sociale 19 persona, orendi shtëpiake 1 familje si dhe janë organizuar testet e Vlerësimit të Integritit për 278 të huaj, prej tyre 47 persona kanë aplikuar për leje qëndrim të përhershëm si dhe 231 persona kanë aplikuar për fitim të shtetësisë së Republikës së Kosovës.</p>
-------	---	-------------	----	---------------------	--	--	---

							Po ashtu gjatë kësaj periudhe 18 (gazetarë Ukrainas dhe Afgan dhe familjarët e tyre) kanë përfituar nga akomodimi i siguruar në kuadër të projektit që mbështet Qeveria. Poashtu nga ky program gazetarët mbështeten edhe me pagesë mujore, ndërsa nga DRPRIH në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, ju ofrohen Voucher (kupona për pako ushqimore dhe higjienike).
1.4.6	Krijimi i Programeve mbështetëse të komunitetit dhe zhvillimi i dialogut ndërkulturor	2021 - 2023	BK UNHCR	MPB Komunat	Organizimi i 3 takimeve të përbashkëta ndërmjet të migrantëve, aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare me anëtarë të komunitetit	Rregullorja për Integrimin e të Huajve QRK 09/2019	Me qëllim të socializmit të personave me mbrojtje ndërkombëtare në Kosovë, është organizuar një aktivitet social (ekskursion) një ditor në Bogë i mbështetur nga UNHCR në bashkëpunim me CRPK dhe JRS- ja dhe koordinim më DRPRIH. Poashtu, DRPRIH në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare për herë të parë në Kosovë, ka çertifikuar me Kursin e Integritimit 21 persona me status të mbrojtjes ndërkombëtare, prej tyre 10 gazetarë nga Ukraina si dhe 11 persona nga vendet e tjera si Siria, Iraku, Turqia etj. Me rastin e çertifikimit është organizuar një ceremoni e përbashkët.
1.4.7	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e web faqes për integrimin e të huajve	2021 - 2022	BK GIZ	MPB	1 web faqe e zhvilluar ku do të plasohen të gjitha informatat relevante të integritimit;	Rregullorja për Integrimin e të Huajve QRK 09/2019	Është në proces zhvillimi i Web-faqes.

1.4.8	Zhvillimi i modulit për menaxhimin e rasteve të integrit të të huajve dhe ndërlidhja me akterët relevant	2021 - 2022	BK GIZ	MPB	1 Modul i zhvilluar dhe integruar në kuadër të Sistemit për Menaxhimin e Rasteve	Rregullorja për Integrimin e të Huajve QRK 09/2019	Është në proces zhvillimi i modulit.
2.	Objektivi Strategjik	Garantimi i Migrimit të Sigurtë, të Organizuar dhe të Rregullt					
2.1	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Informimi i qytetarëve të Kosovës për rregullat e hyrjes dhe qëndrimit në zonën Schengen</i>					
2.1.1	Organizimi i fushatave për të informuar qytetarët për pasojat e migrimit të parregullt dhe abuzimin me të drejtat dhe obligimet e hyrjes dhe qëndrimit në Zonën Schengen pas procesit të liberalizimit të vizave	2021 - 2023	BK, GIZ MIMAK/SD C	MPB ZKM	Në kuadër të fushatës planifikohet të lansohen spote televizive; aplikacioni 'Kalkulatori Schengen'	Plani i Komunikimit të AQM-së Strategjia për komunikim e Procesit të Integrit Evropian Strategjia për komunikim e MPB-së	<p>Grupi Tematik i AQM-së në kuadër të Planit të Komunikimit ka paraparë organizimin e fushatës informuese dhe është duke komunikuar me mekanizmat tjerë institucional në MPB dhe ZIE/ZKM për të koordinuar veprimet në zbatimin e fushatës</p> <p>Dëri më tani janë përgaditur disa produkte si 'Kalkulatori Schengen' dhe video spotet televizive dhe në momentin që kemi udhëzime nga niveli politik, këto produkte do të lansohen dhe publikohen.</p> <p>Është përgatitur Doracaku për mekanizmat institucional lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i liberalizimit të vizave. Poashtu është ndërmarr një vlerësim për menaxhimin e procesit pas-liberalizimit të vizave dhe është hartuar raporti me gjetje dhe rekomandime.</p>
2.1.2	Organizimin e tryezave tematike me Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi me qëllim të	2021 - 2023	BK	MAPL MPB (DSP)	15 Tryeza tematike të organizuara	Plani i Komunikimit të AQM-së	Grupi Tematik i AQM-së në kuadër të Planit të Komunikimit ka paraparë në muajt Shtator-Dhjetor 2023, organizimin e 15 tryezave tematike të cilat do të trajtojnë tema dhe informata relevante praktike për

	koordinimit të aktiviteteve në parandalimin e migrimit të parregullt dhe menaxhimin e procesit pas liberalizimit të vizave						udhëtimin pa viza në Zonën Schengen. Ky aktivitet do të mbështetet nga GIZ/DIMAK.
2.1.3	Organizimin e tubimeve publike (toën hall) për të informuar qytetarët mbi të drejtat dhe obligimet e hyrjes dhe qëndrimit në Zonën Schengen pas procesit të liberalizimit të vizave	2021 - 2022	BK Donatorët, MIMAK / SDC	MPB/A QM MAPL ZKM MASH TI	Së paku 10 tubime publike të organizuara	Plani për komunikim i AQM-së	Grupi Tematik i AQM-së në kuadër të Planit të Komunikimit ka paraparë organizimin e 10 tubimeve publike, përgjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2023. Ky aktivitet do të mbështetet nga GIZ/DIMAK.
2.1.4	Përfshirja e diasporës (rrjetit të bizneseve dhe profesionistëve) në senzibilizimin dhe informimin e qytetarëve të Kosovës në parandalimin e migrimit të parregullt dhe për të drejtat dhe obligimet që dalin nga lëvizja e lirë pa viza në zonën Schengen	2021 - 2023	BK	MPJD MPB	Ne kuadër të organizimit të 3 Forumeve Ekonomike me Diasporën	Plani i Komunikimit të AQM-së	Grupi Tematik i AQM-së në kuadër të Planit të Komunikimit ka paraparë përfshirjen e diasporës në senzibilizim, kryesisht në kuadër të aktiviteteve si: Ditët e diasporës në Kosovë dhe jashtë; Konferencë me bizneset e diasporës; Këshillat e Diasporës në vendet e destinacionit etj. Të gjitha këto aktivitete do të organizohen nga MPJD duke përdorur rrjetet e themeluara tashmë të diasporës dhe duke shfrytëzuar misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

2.1.5	Vendosja e shtandeve informuese në qendrat kryesore të Kosovës me qëllim të ofrimit të informatave praktike mbi të drejtat dhe obligimet e lëvizjes pa viza në zonën Schengen	2021 - 2022	Donatorët MIMAK / SDC	MPB ZKM MAPL	Shtandet e vendosura në 7 qendrat kryesore në Kosovë	Plani për Komunikim i AQM-së	Grupi Tematik i AQM-së në kuadër të Planit të Komunikimit ka paraparë vendosjen e shtandeve informuese përgjatë periudhës Dhjetor 2023 – Mars 2024. Ky aktivitet do të mbështet nga GIZ/DIMAK.
2.2	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Avancimi i bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës me shtetet tjera në garantimin e migrimit të rregullt, të organizuar dhe të sigurt</i>					
2.2.1	Fuqizimi i bashkëpunimit në nivel rajonal përmes organizatave dhe iniciativave ndërkombtare me vendet e prejardhjes dhe të origjinës, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit në parandalimin e migrimit të parregullt	2021 -023	Projekti rajonal BE për menaxhimin e migracionit	MPB MPJD	Kosova dhe vendet e Ballkanit Perëndimor shfrytëzojnë mekanizmat e BE-së dhe organizatave/iniciativave në nivel ndërkombëtar me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit me vendet e origjinës dhe preardhjes së migrantëve të parregullt	Ligji për të Huaj	<p>Gjatë periudhës raportuese Divizioni për Ri pranim dhe kthim ka marrë pjesë në këto Konferenca Rajonale, Iniciativa, Tryeza dhe Trajnime të cilat janë organizuar nga Organizatat ndërkombëtare dhe mekanizmat e BE-se:</p> <p>-Konferencë Rajonale mbi Ripranimin, organizuar nga MARRI, të mbajtur në Sarajevë, datë 29 mars 01 prill 2022;</p> <p>-Trajnim i organizuar nga EASO për Teknikat e intervistimit, mbajtur në Ohër të Maqedonisë së Veriut, me datë: 16-19 Maj 2022;</p> <p>- Konferencë e organizuar nga Joint Center Platform lidhur me zbatimin e PKK-së mbi bashkëpunimin për kthim, mbajtur në Slloveni me datë 20-24 Qershor 2022;</p> <p>-Trajnim i organizuar nga IOM/GMDAC lidhur me ngritjen e kapaciteteve për të dhënat e Migracionit, mbajtur në Turqi, me datë: 03-04 Tetor 2022;</p>

						<p>-Trajnim i organizuar nga EASO lidhur me Teknikat e Intervistimit, mbajtur në Mal të Zi, me datë: 24-26 Tetor 2022;</p> <p>-Konferencë lidhur me "Këshillimet për fëmijët dhe familjet ne procesin e kthimit, mbajtur në Beograd, me datë: 17-18 Tetor 2022;</p> <p>-Tryezë e mbajtur në platformën ONLINE, me datë: 20 Tetor 2022, organizuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit (IRC) me partneritet me Qendrën Psiko Sociale Vatra (Shqipëri), Vasa Prava (Bosnje e Hercegovinë), Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (Kosovë) dhe Shoqata për Luftimin e trafikimit te qenieve njerzore ATINA (Serbi);</p> <p>-Punëtori organizuar nga UNHCR lidhur me Trajtimin e fëmijëve të huaj mbajtur në Prishtinë me datë: 19 Tetor 2022;</p> <p>-Punëtori organizuar nga Misioni EUAA lidhur me Sigurimin e informacionit dhe identifikimi i personave me nevoja të veqanta në Qendrat e pritjes, mbajtur në Prishtinë me datë: 30 Nëntor 2022;</p> <p>-Takim rajonal organizuar nga IOM në formatin online lidhur me nivelin e zabtimit të programit të kthimit asistuar vullnetar, mbajtur me datë 8 Dhjetor 2022;</p> <p>-Punëtori e organizuar nga KRCT/UNHCR lidhur me "Udhëzuesin për parandalimin, menaxhimin e riskut dhe përgjigjen ndaj dhunës së bazuar në gjini në</p>
--	--	--	--	--	--	--

						<p>kontekst të migracionit të përzier në Republikën e Kosovës", mbajtur në Prishtinë me datë: 09 Dhjetor 2022;</p> <p>-Tryezë Pune e organizuar nga CRPK/UNHCR lidhur me hartimin e udhëzuesit për përcaktimin e moshës së fëmijëve azilkërkues, refugjat dhe migrant, mbajtur në Prishtinë me datë: 16 Dhjetor 2022;</p> <p>-Tryezë Pune e organizuar nga IOM lidhur me përdorimin e informatave nga vendi i origjinës gjatë procedurës së Azilit, mbajtur në Prishtinë me datë: 28 Dhjetor 2022.</p>	
2.2.2	Inicimi dhe negocimi i marrëveshjeve bilaterale për ripranim dhe kthim;	2021 - 2023	BK	MPB MPJD	<p>Përgjatë periudhës së ardhshme tre vjeçare janë paraparë të iniciohen dhe negocohen 13 (Mbretërinë e Bashkuar, Portugalinë, Lituaninë, Poloninë, Irlandë, Pakistanin, Afganistanin, Bregun e Fildishtë, SHBA-të, Egjipti, Jordaninë, Libinë dhe Qadin) marrëveshje për ripranim dhe kthim</p>	Plani i punës së MPB-së	<p>Divizioni për Ripranim dhe Kthim në DSHAM, gjatë periudhës raportuese, ka përgaditur gjithsejt 14 Projekt Marrëveshje Ndërkombëtare për Ripranim të cilat me datë 04 Korrik 2022 janë aprovuar në parim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Projekt Marrëveshjet në fjalë janë me këto shtete: Letoninë, Lituaninë, Pakistanin, Irlandën, Egjiptin, Jordanin, Portugalinë, Poloninë, Libinë, Çadin, SHBA-në, Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, Bregun e Fildishtë dhe Australinë.</p> <p>Të gjitha këto projekt Marrëveshje janë dërguar përmes kanaleve diplomatike tek shtetet e lartë cekura dhe jemi në pritje të përgjigjeve nese ka gadishmëri për negocimin dhe nënshkrimin e tyre.</p>

2.2.3	Plotësim-ndryshimi i legjislacionit sekondar përmes së cilit synohet të lehtësimi i procesit të ripranimit	2021	BK	MPB	Është paraparë plotësim-ndryshimi i këtyre Udhëzimeve Administrative: UA MPB 05/2017; UA MPB 17/2015; UA MPB 24/2015	Plani legjislativ për aktet nën-ligjore të MPB-së për vitin 2021	<p>Nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti për shkak se ende nuk është miratuar plotësim-ndryshimi i Ligjit për Shtetësi për të krijuar bazën ligjore për plotësim ndryshimin e akteve nën-ligjore.</p> <p>Poashtu, rekomandohet që ky aktivitet të bartet tek objektivi 1.2. i këtij Plani, pasi që i referohet procesit të riintegritimit përkatsisht regjistrimit të personave të ripranuar.</p>
2.2.4	Vlerësi periodik i zbatimit të Marrëveshjeve për Ripranim si dhe krijimi i grupeve teknike të ekspertëve në nivel bilateral për të adresuar sfidat në procesin e ripranimit	2021	BK	MPB MPJD	Vlerësimet do të jenë në baza 6 mujore ndërsa në fillimisht fokusi do të jetë në krijimin grupeve teknike të ekspertëve në nivel bilateral me Gjermaninë dhe Francën	Marrëveshjet për Ripranim	<p>Në muajin Mars 2022 është mbajtur një takim me autoritetet gjermane ku është diskutuar lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit dhe problemeve në zbatim.</p> <p>Me datë 28 Qershor 2022 është mbajtur takimi i delegacioneve Kosovë – Shqipëri me temë diskutimi – Niveli i zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Janë caktuar ekspertët e të dyja delegacioneve dhe janë adresuar rekomandimet e dala nga ai takim.</p> <p>Me datë 10 Maj 2023 është mbajtur takimi i Komitetit të Përbashkët me Malin e Zi ku është diskutuar lidhur me zbatimin e marrëveshjes për Ripranim në mes dyja vendeve, me ç'rast është konkluduar se bashkëpunimi është në nivel të shkëlqyeshëm.</p> <p>Ndërsa, sa i përket Francës, në takimin e mbajtur me datë 06 Korrik 2021 është diskutuar mes tjerash për bashkëpunimin në fushën e ripranimit si dhe janë prezentuar disa propozime të palës kosovare lidhur me</p>

							parandalimin e migrimit të parregullt dhe bashkëpunimin në procesin e kthimit. Dëri më tani nga pala franceze nuk kemi pranuar përgjigje në propozimet tona apo ndonjë kërkesë për takim, mbase edhe për shkak të konsideratës nga se nuk ka ndonjë sfidë në bashkëpunimin sa i përket procesit të ripranimit.
2.2.5	Avancimi i sistemit të regjistrimit, profilizimit dhe referimit të migrantëve	2021 - 2022	Projekti Rajonal i BE-se Instrumenti për Stabilitet dhe Paqe Implementuar nga IOM	MPB	Ngritja dhe funksionalizimi i Qendrës së Pritjes Rregullorja e Punës së Qendrës e miratuar dhe stafi përgjegjës i trajnuar	Plani i Reagimit për Menaxhimin e fluksit të mundshëm të migrantëve , refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare	<p>Me datë 24 Qershor 2022, Ministri i Punëve të Brendshme ka nënshkruar Vendimin Nr.04/90 për themelimin e Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë.</p> <p>Qendra e Përkohshme e Pritjes tashmë është përfshirë si strukturë organizative edhe në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të MPB-së të miratuar në muajin Mars 2023.</p> <p>Poashtu është miratuar Udhëzuesi për funksionimin e Qendrës si dhe është caktuar Udhëheqësi dhe është paraparë stafi mbështetës për funksionim.</p> <p>Qendra e Përkohshme e Pritjes është plotësisht funksionale ndërsa me projektin e SDC/IOM pritet që të vazhdohet me trajnimin e stafit në aspektet e profilizimit dhe referimit të migrantëve.</p>

2.2.6	Avancimi dhe operacionalizimi i Programit për kthimin e asistuar vullnetar të migrantëve të parregullt dhe rritja e bashkëpunimit me Misionet Diplomatike me qëllim të arritjes së Marrëveshjeve për riatdhesim me Shtetet e Origjinës	2021 - 2023	Donatorët IOM	MPB IOM	Në periudhën e ardhshme 3 vjeçare është paraparë kthimi i asistuar për 40-60 persona 10 zyrtarë dhe staf i OJQ-ve të trajnuar për mekanizmat e kthimit të asistuar vullnetar 2 Trajnime në nivel nacional do të organizohen për zyrtarët e kthimit bashkë edhe me 2 punëtorë me Misionet Diplomatike në nivel regjional	Ligji për të Huaj Udhëzimi Administrativ për kthimin e të huajve me qëndrim të parregullt dhe Memorandum Bashkëpunimi në mes të MPB-së dhe IOM-it	Përgjatë vitit 2022 janë kthyer gjithsej 15 migrantë përmes kthimit të Asistuar Vullnetar nga IOM. Ndërsa nga Janari deri më 31 Mars 2023 janë kthyer 2 migrantë përmes këtij mekanizmi. Gjatë periudhës raportuese është mbajtur edhe një trajnim i organizuar nga IOM me temën 'Këshillimet për fëmijët dhe familjen në procesin e kthimit' të mbajtur në Beograd më 17 dhe 18 tetor 2022.
2.2.7	Zhvillimi i Masterplanit për përgatitja e infrastrukturës për kyçje me sistemin EURODAC	2022 - 2023	Donatorët Komisioni Evropian	MPB FRONT EX	Infrastruktura në nivel vendor e përshtatur për kyçje në sistemin e EURODAC-ut	Studimi dhe Fizibiliteti i përgaditur nga Projekti Rajonal IPA 2	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti, megjithatë ky aktivitet do të adresohet në kuadër të projektit rajonal IPA 3 të implementuar nga IOM.

2.2.8	Avancimi i sistemit për marrjen e shenjave biometrike për migrantë dhe refugjatë	2021 - 2022	Donatorët Sekretariati për Migracion i Zvicrës (SEM)	PK	Sigurimi i 30 seteve të pajisjeve për marrjen e të dhënave biometrike për migrantë dhe refugjatë 30 Hand Held (tableta) fingerprint +MRZ reader	Plani për Menaxhimin e fluksit të mundshëm të migrantë/refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare	<p>Me 27.04.2022 Departamenti i Kufirit në Policinë e Kosovës ka pranuar donacionin nga Qeveria Zvicrane (SEM). Pjesë e këtij donacioni janë këto pajisje: 30 lexues të gjurmëve të gishtrinjëve, 26 tablet mobil me funksion për lexim të gjurmëve të gishtrinjëve si dhe 56 licenca që mundësojnë ndërlidhjen e këtyre pajisjeve me sistemin AFIS.</p> <p>Poashtu janë blerë 26 SIM kartela mbi bazën e të cilave funksionojnë në terren këto pajisje mobile. Aktualisht është në proces e sipër ndërlidhja e këtyre pajisjeve në kompjuterët fiks të PK-së me sistemin e AFIS-it.</p> <p>Ndërsa intervenimet në aspektin softuerik dhe ndërlidhja me sistemin AFIS është paraparë si aktivitet në kuadër të projektit të SDC/IOM i cili ka filluar së implementuari më datë 22 Maj 2023.</p>
2.2.9	Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e IT-së dhe zyrtarët policor për përdorimin e pajisjeve për marrjen e shenjave biometrike për migrantë dhe refugjat	2021 - 2022	Donatorët Sekretariati për Migracion i Zvicrës (SEM)	PK	4 zyrtarë të IT-së dhe 286 zyrtarë policor të trajnuar	Plani për Menaxhimin e fluksit të mundshëm të migrantëve/refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare	Përgjatë vitit 2022 janë trajnuar 80 zyrtarë policor të Departamentit të Kufirit. Ndërsa në muajin Janar 2023, Departamenti i Kufirit ka realizuar trajnimin edhe për 29 zyrtarë policor të cilët do t'i përdorin këto pajisje.

2.2.10	Forcimi i bashkëpunimit me FRONTEX	2021 - 2023	BK FRONTEX	PK	<p>Shkëmbimi i të dhënave në baza mujore;</p> <p>Përpilimi i analizave të përbashkëta të riskut</p> <p>Zbatimi i planeve të përbashkëta operative;</p> <p>Pjesëmarrja në trajnime sipas moduleve të FRONTEX</p>	Marrëveshja teknike në mes të MPB-së dhe FRONTEX	<p>Me qëllim të fuqizimit të sistemit për menaxhimin e kufirit Policia e Kosovës bën shkëmbimin e rregullt të informatave dhe raporteve me agjensionet e BE-së si dhe me FRONTEX-in. Gjatë vitit 2022 janë shkëmbyer: 24 raporte mujore, si dhe është bërë raportimi i përditshëm në platformën JORA në FRONTEX. Poashtu janë organizuar 5 aktivitetet operacionale me pjesëmarrje të 8 zyrtarëve policor, ndërsa 29 zyrtarë policor nga vendet e BE-së kanë qendruar në Pikat e Kalimit të Kufirat në ANP, Hanin e Elezit dhe Vërmicë.</p> <p>Ndërsa për periudhën raportuese Janar-Maj 2023 janë shkëmbyer: 5 raporte mujore, si dhe është bërë raportimi i përditshëm në platformën JORA në FRONTEX. Poashtu, Koordinatori Nacional së bashku me 3 Koordinatorët Lokal me FRONTEX-in kanë marr pjesë në takimin e rregullt të koordinatorëve lokal në Varshavë.</p> <p>Ndërsa, zyrtarët e FRONTEX-it janë duke marrë pjesë aktive në kuadër të aktiviteteve operacionale në PKK Vërmicë 3 zyrtarë, PKK Hani i Elezit 4 Zyrtarë dhe në Aeroportin e Prishtinës 3 zyrtarë.</p>
2.2.11	Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e kontrabandimit të migrantëve;	2021 - 2023	BK	PK	<p>Numri i informatave të shkëmbyera; krijimi i ekipeve të përbashkëta hetimore; raste të hetuara; takime të përbashkëta në nivel operativ</p>	Plani i Punës së PK-së	<p>Departamenti i Kufirit në Policinë e Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të Kontrabandimit me migrantë gjatë vitit 2022 janë iniciuar 37 raste, ndërsa janë shkëmbyer 72 informata të inteligjencës.</p> <p>Në periudhën Janar-Maj 2023 janë iniciuar 5 raste të Kontrabandimit me migrantë, ndërsa për të njëjtën vepër penale janë shkëmbyer 21 informata inteligjente.</p>

						<p>Ndërsa, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar gjatë periudhës kohore Janar –Dhjetor 2022 ka shkëmbyer 7 informata në lidhje me veprën penale kontrabandë me migrantë.</p> <p>Poashtu, janë mbajtur dy takime operationale jashtë shtetit me qëllim koordinimin e veprimeve hetimore në luftimin e kontrabandës me migrantë, ndërsa gjatë periudhës Janar – Mars 2023 janë duke u trajtuar dy informata lidhur me veprën Kontrabandim me Migrantë dhe falsifikim të dokumenteve me qëllim të kontrabandimit.</p>
2.2.12	Ngritja e kapaciteteve për teknikat e intervistimit dhe te ekzaminimit	2021 - 2023	Projekti Rajonal BE IPA II, për menaxhimin e migracionit me fokus te mbrojtja ne BP	MPB PK Frontex IOM	Trajnim për trajner (4 zyrtare policor) dhe 2 trajnime nacionale (2x20 zyrtarë)	<p>Gjatë vitit 2022 bazuar në planifikimet vjetore nga FRONTEX-i ka qenë e paraparë që 10 zyrtarë policor kufitar në periudha të ndryshme mujore të marrin pjesë në operationet tokësore në vendet e BE, por për shkak të situatës së krijuar në shtetin e Ukrainës, disa nga këto aktivitete janë anuluar, megjithatë në muajin Tetor-Nëntor 2022 dy (2) zyrtarë kanë marrë pjesë në operationet ajrore në Aeroportin e Vjenës si dhe dy (2) zyrtarë tjerë kanë qendruar për vizitë një javore në Aeroportin e Basel-it me qëllim shkëmbimin e praktikave.</p> <p>Ndërsa gjatë vitit 2023, nga Policia Kufitare është paraparë të marrin pjesë dy (2) zyrtarë policor nga Aeroporti i Prishtinës në Aeroportin e Milanos në kuadër të programit Exchange (shkëmbim përvojave). Poashtu, dy (2) zyrtar do të marrin pjesë në kuadër të programit aktivitete operationale ajrore në aeroportin Mulhouse-Basel France, një (1) zyrtar do të marrë pjesë në programin Exchange tokësor ne Stara Gradiska,</p>

							Kroaci, dhe tre (3) zyrtarë policor do te marrin pjesë në kuadër të programit aktivitete operacionale tokësore në periudha të ndryshme dhe në shtete të ndryshme në kohëzgjatje prej një muaji.
2.2.13	Avancimi i bashkëpunimit me shtetet tjera përmes misioneve diplomatike dhe konsullore në shkëmbimin e informatave në fushën e migrimit	2021 - 2023	BK	MPB MPJD	Në periudhën 2021-2023 është paraparë të lidhen 3 marrëveshje ndërkombëtare të cilat mes tjerash rregullojnë shkëmbimin e informatave në fushën e migrimit	Avancimi i bashkëpunimit me shtetet tjera përmes misioneve diplomatike dhe konsullore në shkëmbimin e informatave në fushën e migrimit	<p>Në periudhën raportuese ka pasur disa lëvizje sa i përket avancimit të bashkëpunimit me shtete tjera në fushën e migrimit. Në këtë kontekst, është në proces e sipër rishikimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në fushën e Migrimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Hungarisë i vitit 2013, bashkëpunim ky i cili do të zgjerohet edhe në fushën e shkëmbimit të informatave dhe përvojave në menaxhimin e migrimit. Drafti i ri i marrëveshjes është finalizuar dhe pritet dakordimi për procedurat e nënshkrimit.</p> <p>Poashtu, janë zhvilluar disa takime me autoritetet e Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar me fokus në avancimin e bashkëpunimit në fushën e migrimit.</p> <p>Pritet në muajt në vijim të ketë edhe iniciativa me vende tjera me interes për të bashkëpunuar në fushën e migrimit.</p>
2.3	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Avancimi i sistemit të kontrollit të hyrjes dhe qëndrimit të të huajve në Republikën e Kosovës</i>					
2.3.1	Rishikimi i procedurave dhe funksionalizimi i infrastrukturës në Pikat e Kalimit të Kufirit për ekzaminimin e fluksve e të përziera të migrantëve duke përfshirë kontrollin	2021 - 2023	BK	MPB/P K MSH	Cdo migrant i nënshtrohet ekzaminimit shëndetësor dhe të sigurisë në Pikën e Kalimit të Kufirit		<p>Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti.</p> <p>Rekomandohet që ky aktivitet të largohet në tërësi gjatë rishikimit të Planit të Veprimit sepse këto çështje trajtohen në kuadër të Planit të Reagimit në rast të fluksit të migrantëve.</p>

	shëndetësor, të sigurisë dhe identitetit si dhe identifikimi i aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare dhe sigurimi i qasjes ne procedurat e azilit.					
2.3.2	Rritja e mbikëqyrjes së pikave të kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër bazuar në konceptin e policimit të udhëhequr nga intelegjenca me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të kalimeve të paautorizuara të kufirit shtetëror dhe kontrabandimit të migrantëve dhe refugjatëve	2021 - 2023	BK	QKMK PK	Numri i informatave inteligjente dhe planeve operacionale të bazuar në intelegjencë	<p>Me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të kalimeve ilegale të kufirit dhe kontrabandimit me migrantë, janë shkëmbyer 72 informata të inteligjencës, ndërsa ka qenë në vazhdimësi zbatimi i planit operativ 'Migrimi i Parregullt' përgjatë gjithë kufirit të Republikës së Kosovës.</p> <p>Poashtu QKMK ka pregaditur 12 Raporte të vlerësimit dhe analizës së riskut në kufi lidhur me veprat penale që ndodhin në PKK dhe vijë të gjelbër ndër to edhe çështja e kontrabandimit me migrant si dhe është realizuar koordinimi i dy (2) planeve Operative, 'Ditët e veprimit të përbashkët' me ILECU-n dhe Autoritetet e MIK-ut ku ndër çështjet tjera ishte edhe çështja e kontrabandimit me migrant.</p>
2.3.3	Funksionalizimi i modulit të ri në Sistemin për Menaxhimin e Kufirit përmes së cilit mundësohet në PKK dhe në brendi të vendit përlllogaritja automatike e afatit të lejuar të qëndrimit	2021	BK	PK	Sistemi i Menaxhimit Kufitar (BMS) me qëllim të identifikimit të shtetasve të huaj të cilët nuk plotësojnë kushtet e hyrjes i avancuar	Implementimi i zgjidhjes për kalkulim dhe alarmim të mbiqëndrimit 90 ditë brenda 180 ditëve është bërë nga viti 2016, por nuk ende nuk është aprovuar lëshimi i tij në funksion. Momentalisht, sistemi i kalkulon ditët tek hyrja/dalja e fundit dhe e sygjeron me ngjyrë të kuqe nëse ka me shumë se 90 ditë qëndrim brenda 180 ditëve, por pa alert.

							Për rastet tjera në brendi të vendit, sistemi e ka një raport i cili paraqet tek të gjithë personat në listë të cilët kanë kaluar 90+ ditë brenda 180 ditëve.
2.3.4	Rritja e numrit të inspektimeve të përbashkëta ng Inspektorati i Punës dhe Policia e Kosovës lidhur me të Huajt që punojnë në Kosovë dhe punëdhënësve të tyre	2021 - 2023	BK	PK Inspektorati i Punës	6 Inspektime të rregullta dhe të përbashkëta brenda vitit (18 gjithsejt) në mes të DMH-së dhe Inspektoratit të Punës		<p>Gjatë vitit 2022- është realizuar bashkëpunimi në mes të DMH-së dhe Inspektoratit të Punës ku është bërë inspektimi i një (1) biznesi dhe ka rezultuar me: inspektimin e 11 Nën-kompanive ku kemi hasur në 25 shtetas nga Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Shqipëria të cilët punonin në këtë veprimtari në kundërshtim me Ligjin për të Huaj.</p> <p>Ndërsa në periudhën raportuese Janar – Maj 2023, në organizim të DHTQNJ dhe në bashkëpunim edhe me Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj, Administratën Tatimore të Kosovës, Inspektorët e MINT dhe Inspektorët e Punës është realizuar Plani Operativ "STUHIA 2023". Gjatë këtij plani janë realizuar 11 Inspektime të klubeve të natës të cilët organizojnë muzikë Live. Gjatë këtij plani, janë hasur 39 shtetase nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut , Mali i Zi, Serbia dhe Kolumbia të cilat punonin në këtë veprimtari në kundërshtim me Ligjin për të Huaj.</p>
2.3.5	Hartimi i manualit për identifikimin, profilizimin dhe referimin e rasteve të migrantëve të parregullt dhe refugjatëve përfshirë edhe grupet e cenushme	2021	IOM UNHCR	PK			Është hartuar dhe shpërndarë për përdorim Udhëzuesi për Vlerësimin dhe Përcaktimin e interesit më të mirë të fëmijëve aplikues për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatë dhe migrantë në Kosovë të cilët janë përpiluar nga DSHAM-i me pjesëmarrje edhe të PK-se dhe akterëve tjerë.

							<p>Poashtu është hartuar Udhëzuesi për Kushtet e Pranimit për Aplikuesit për Mbrojtje Ndërkombëtare në pozitë të cenushme.</p> <p>Ky aktivitet konsiderohet i përmbushur.</p>
2.4	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Mbrojtja e migrantëve nga trafikimi</i>					
2.4.1	Identifikimi i hershëm dhe referimi i viktimave potenciale të trafikimit gjatë procedurës së trajtimit të migrantëve	2021 - 2023	BK	MPB PK	Numri i viktimave të identifikuar dhe referuara	<p>Procedura Standarde Operimit për identifikimin e hershëm të migrantëve të cilët mund të jenë viktimat e trafikimit me qenie njerëzore</p>	<p>Përgjatë periudhës raportuese nuk është identifikuar asnjë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore në mesin e migrantëve.</p> <p>Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore me mbështetje të UNHCR-it, me datë 22/10/2022 ka mbajtur një ligjeratë zyrtarët policor të Departamentit të Kufirit si dhe për zyrtarët e Qendrës së Azilit dhe asaj për të Huajt, për të informuar lidhur me indikatorët dhe referimin e rasteve të dyshuara si viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.</p>
2.4.2	Trajnime të përbashkëta të Policisë Kufitare dhe DHTQNJ për identifikimin dhe mbrojtjen e migrantëve nga trafikimi dhe kontrabandimi	2021 - 2022	BK	PK	Në periudhën 2021-2022 janë paraparë të organizohen 4 trajnime të përbashkëta	<p>Plani i trajnimeve të PK-së</p>	<p>Gjatë vitit 2022 sa i përket bashkëpunimit të Policisë Kufitare dhe DHTQNJ për identifikimin dhe mbrojtjen e migrantëve nga trafikimi janë mbajtur 7 trajnime në të cilat kanë marrë pjesë 13 zyrtarë nga Departamenti i Policisë Kufitare.</p> <p>Poashtu, DHTQNJ-je ka mbajtur prezentime/ligjeratë në 8 rajone ku kanë marrë pjesë 139 zyrtarë policor nga Departamenti i Kufirit lidhur me Indikatorët e hershëm për identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.</p>

							Ndërsa në periudhën raportuese Janar - Mars 2023, DHTQNJ-je së bashku me Policinë Kufitare kane mbajtur një (1) Trajnim për ndërtimin e kapaciteteve mbi identifikimin fillestar të viktimave të trafikimit ku pjesëmarrës kanë qenë 14 zyrtarë policor.
2.4.3	Inspektive të përbashkëta të DHTQNJ me DMH në identifikimin e hershëm të viktimave potenciale të trafikimit	2021 - 2023	BK	PK	Në periudhën 2021-2023 janë paraparë të ndermirren 6 inspektive të përbashkëta	Inspektive të përbashkëta të DHTQNJ me DMH në identifikimin e hershëm të viktimave potenciale të trafikimit	DHTQNJ dhe DMH me qëllim të identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit, përgjatë viti 2022 kanë inspektuar 194 lokale të konsideruara si vende sensitive (masazha, kafene etj). Ndërsa gjatë periudhës Janar-Mars 2023, DHTQNJ-DMH, kanë ndërmarrë 5 operacione 'Kontrollimi i lokaleve sensitive (Masazha, Kafene)' me qëllim të identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit, si dhe identifikimin e femijëve në situatë rruge si viktima të mundshme të trafikimit.
2.4.4	Plane të përbashkëta operacionale bazuar në informata të intelgjencës nga DHTQNJ dhe DMH	2021 - 2023	BK	PK	Në periudhën 2021-2023 pritet të ketë së paku 10 operacione të përbashkëta		DHTQNJ dhe DMH, bazuar në informata të intelgjencës kanë zbatuar 19 plane të përbashkëta operacionale për inspektive në lokacione sensitive. Ndërsa gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, DHTQNJ dhe DMH, kanë organizuar dhe zbatuar tre (3) Plane Operacionale, nga të cilat dy (2) plane për inspektive në lokacione sensitive dhe një (1) plan identifikimin e femijëve në situatë rruge si viktima të mundshme të trafikimit.
2.4.5	Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në shkëmbimin e	2021 - 2023	BK Projekti Rajonal BE	PK	Përgjatë viteve 2021-2023 janë paraparë të mbahen 6 trajnime	Strategjia e MARI-it	Gjatë vitit 2022 në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar janë organizuar:

	informatave dhe trajnime të specializuara në identifikimin e hershëm të viktimave potenciale të trafikimit në mesin e migrantëve		IPA II, për menaxhimin e migracionit me fokus të mbrojtjes në BP				<p>2 - takime operacionale;</p> <p>32 - informata të shkëmbyera me shtete të tjera;</p> <p>14 - Trajnime me karakter ndërkombëtar (disa prej tyre janë mbajtur Online).</p> <p>Ndërsa gjatë periudhës Janar – Mars 2023 janë organizuar:</p> <p>2 – konferenca të karakterit ndërkombëtar ku janë trajtuar temat si Migrimi dhe Mbrojtja nga Trafikimi;</p> <p>15 – informata të shkëmbyera me shtete të tjera.</p>
3.	Objektivi Strategjik	Menaxhimi i Migrimit të Brendshëm					
3.1	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Rishikimi i sistemit aktual të migrimit të brendshëm</i>					
3.1.1	Vlerësim i kornizës ligjore dhe institucionale	2021	Donatorët, MIMAK/SD C	MPB (ARC) MAPL ASK	<p>1 Koncept dokument për Ligjin për Vendbanim dhe Vendqëndrim i hartuar dhe miratuar</p> <p>1 Raport mbi kapacitetet institucionale për menaxhimin e të dhënave lidhur me migrimin e brendshëm</p>	Programi qeveritar për koncept dokumente për vitin 2021	<p>Koncept dokument për Ligjin për Vendbanim dhe Vendqëndrim është finalizuar. Pritet themelimi i kryesuesit të Grupit Punues për të nisur punën në hartimin e projektligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim.</p> <p>Po ashtu, me përkrahjen e projektit MIMAK është realizuar një vlerësim i kornizës ligjore, institucionale dhe të infrastrukturës së IT-së që lidhet me migrimin e brendshëm.</p>
3.1.2	Vlerësim i sistemeve për mbledhjen dhe gjenerimin e të dhënave që	2021	Donatorët MIMAK/SD C	MPB/ARC	1 Raport mbi vlerësimin e sistemit për mbledhjen dhe gjenerimin e të		Vlerësim i sistemeve për mbledhjen dhe gjenerimin e të dhënave që ndërlidhen me migrimin e brendshëm është realizuar në kuadër të vlerësimit të sistemit të

	ndërlidhen me migrimin e brendshëm				dhënave që ndërlidhen me migrimin e brendshëm		migrimit të brendshëm të cekur në kuadër të aktivitetit 3.1.1
3.1.3	Hartimi i Planit për avancimin e sistemit të migrimit të brendshëm	2021	Donatorët MIMAK/SD C	AQM	1 Plan i hartuar dhe aprovuar nga Qeveria	Raporti mbi të gjeturat e vlerësimit të kornizës ligjore, institucionale dhe sistemit për mbledhjen dhe gjenerimin e të dhënave që ndërlidhen me migrimin e brendshëm	Me përkrahje të projektit MIMAK është hartuar plani për avancimin e sistemit të migrimit të brendshëm. Zbatimi i Planit do të koordinohet nga AQM përkatësisht Grupi Tematik për Migrimin e Brendshëm si dhe do të përkrahet nga Projekti SDC/IOM.
3.1.4	Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët e AQM-së në fushën e migrimit të brendshëm	2021	Donatorët, MIMAK/SD C	AQM	1 Trajnim dhe 2 Punëtori të organizuara për anëtarët e AQM-së		Është mbajtur një trajnim teorik lidhur me migrimin e brendshëm, si dhe janë mbajtur dy punëtori që kanë rezultuar me hartimin e 2 dokumenteve të politikave që lidhen me migrimin e brendshëm. Ndërkohë, në kuadër të projektit të sapo filluar të SDC/IOM është paraparë ngritja e kapaciteteve të Grupit Tematik të AQM-së për Migrimin e Brendshëm.
3.2	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Avancimi i sistemit të migrimit të brendshëm</i>					

3.2.1	Avancimi i sistemit të gjendjes civile për migrimin e brendshëm si dhe harmonizimi dhe ndërlidhja me sistemet tjera të menaxhimit të të dhënave në përputhje me Ligjin mbi Vendbanimin dhe Vendqëndrimin	2021 - 2022	BK	ARC/MPB	1 Bazë e të Dhënave për migrimin e brendshëm e avancuar dhe në funksion	Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrimin	<p>Grupi Punues për hartimin e Projekt Ligjit të ARC-së, ka dërguar draftin final të Projekt Ligjit, për miratim në Qeveri. Ligji i ri krijon bazën ligjore për miratimin e Rregullores së ARC-së e cila tashmë është finalizuar, ku është paraparë edhe themelimi i Divizionit të Vendbanimit në kuadër të Drejtoratit të Gjendjes Civile.</p> <p>Pas krijimit të këtij divizioni do të krijohet edhe regjistri elektronik përkatës. Pastaj ky regjistrë do të ndërlidhet edhe me regjistrin e gjendjes civile si dhe sistemet tjera sipas nevojës.</p> <p>Ndërkohë, ARC në koordinim me Agjencionin Kadastral është duke e pilotuar në komunën e Mitrovicës dhe Istogut, projektin e ndërlidhjes së qytetarit me adresa.</p>
3.2.2	Krijimi i Divizionit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil	2021	BK	ARC	Divizioni funksional dhe 5 zyrtarë të transferuar brenda ARC-së	Rregullorja e Brendshme	Duke ju referuar raportimit në aktivitetin 3.2.1. jemi në pritje të miratimit të Ligjit për ARC-në për të vazhduar pastaj me aktivitetet tjera siç është krijimi i Divizionit për Vendbanim.
3.2.3	Trajnimi i zyrtarëve publikë në nivel qendror dhe lokal të cilët merren me regjistrimin e ndryshimit të vendbanimit, analizimin dhe përpunimin e të dhënave etj	2021 - 2022	BK	ARC/MPB MAPL	600 zyrtarë të gjendjes civile në nivel qendror dhe lokal të trajnuar	Ligji mbi Vendbanimin dhe Vendqëndrimin Plani për ngritjen e sistemit të integruar të migrimit	<p>Duke ju referuar raportimit në aktivitetin 3.2.1. jemi në pritje të miratimit të Ligjit për ARC-në për të vazhduar pastaj me aktivitetet tjera siç është krijimi i Divizionit për Vendbanim.</p> <p>Pas krijimit të këtij divizioni do të krijohet edhe regjistri elektronik përkatës. Pastaj do të bëhet edhe trajnimi i zyrtarëve përkatës rreth përdorimit të regjistrit elektronik.</p>

						të brendshëm	
3.2.4	Zhvillimi i fushatave informuese me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve mbi obligimin për regjistrimin dhe lajmërimin e ndryshimit të vendbanimit nga një komunë në komunën tjetër	2021 - 2022	Donatorët MIMAK/SD C	AQM	1 fushatë informuese e implementuar	Plani për ngritjen e sistemit të integruar të migrimit të brendshëm	Me përkrahjen e projektit MIMAK është përgaditur një koncept lidhur me fushatat informuese që kanë të bëjnë me obligimin për regjistrimin dhe lajmërimin e ndryshimit të vendbanimit nga një komunë në komunën tjetër. Poashtu në Planin e Komunikimit të AQM-së janë paraparë disa aktivitete në funksion të ngritjes së vetdijesimit të qytetarëve për regjistrimin e ndryshimit të vendbanimit. Këto aktivitete do të zbatohen me mbështetjen e projektit të SDC/IOM.
4.	Objektivi Strategjik	Avancimi në Fushën e Menaxhimit të Migrimit					
4.1	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Fuqizimi i rolit të Autoritetit Qeveritar për Migrim (AQM)</i>					
4.1.1	Miratimi i Rregullores për AQM	2021	BK	ZKM MPB MFPT	Rregullorja e miratuar	Plani i Akteve Nënligjore të Qeverisë për vitin 2021	Me datë 14 Shtator 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin Nr14/96 për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim duke shfuqizuar vendimin Nr 08/158 të datës 29 Nëntor 2013.
4.1.2	Miratimi i vendimit për caktimin e antarëve të përhershëm të AQM-së	2021	BK	ZKM MFPT MPB	Vendimi i miratuar nga Qeveria	Rregullorja e AQM-së	Sipas Vendimit të Qeverisë Nr.14/96, të gjitha institucionet përfaqësuese në AQM, kanë caktuar anëtarët e përhershëm në AQM.
4.1.3	Hartimi i Procedurave të punës për AQM	2021	Donacion MIMAK/SDC	AQM	Procedura e punës për AQM-në e hartuar dhe miratur	Rregullorja për Funksionim	Është hartuar dhe miratuar (me datë 11 Tetor 2022), Udhëzuesi për Funksionimin e Brendshëm të AQM.

						in e AQM-së	<p>Poashtu me vendim të Kryesuesit të AQM-së , me datë 13 Dhjetor 2022, janë themeluar 6 Grupe Tematike të AQM-së , përkatsisht: Grupi Tematik për Migrimin e Rregullt/Mobilitetin, Grupit Tematik për Migrimin e Parregullt, Grupit Tematik për Migrimin e Brendshëm, Grupi Tematik për të Dhëna/Analiza, Grupi Tematik për Riintegrim dhe Integrimin e të Huajve dhe Grupi Tematik për Komunikim/Informim.</p> <p>Poashtu është hartuar udhëzuesi praktik për ndërlidhjen e secilit grup tematik me nivelin strategjik të AQM-së. Deri më tani, tre nga gjashtë Grupet Tematike janë funksionale dhe kanë miratuar planet e tyre vjetore të punës në përputhje me planin vjetor të punës së AQM-së .</p>
4.1.4	Organizimi i tryezave dhe konferencave tematike në fushën e migrimit	2021 - 2023	Donacion MIMAK/ SDC GIZ	AQM MPB MPJD ZKM	6 Tryeza tematike në nivel vendi dhe 2 Konferencë në nivel rajonal për çështje të migrimit	Plani i Komunikimit të AQM-së	<p>Më 15 Dhjetor 2022 Grupi për Balkan BPRG ka organizuar tryezën ‘Emigrimi i punëtorëve shëndetësor’ ku është prezentuar edhe një hulumtim për këtë temë.</p> <p>Më datë 16 Dhjetor 2022, APRK ka organizuar tryezën tematike ‘Ndikimi i emigrimit në tregun e punës në Kosovë’.</p>
4.1.5	Ngritja e kapaciteteve të antarëve të AQM-së dhe Institucioneve/Departamenteve tjera relevante për të zhvilluar analiza në fushën e migrimit	2021 - 2022	Donatorë MIMAK/ SDC GIZ	AQM Institucionet tjera relevante në fushën e	12 Trajnime dhe Punëtori të mbajtura	Plani i Punës së AQM-së	<p>Me mbështetje të GIZ/DIMAK është organizuar ‘Trajnimi i Trajnerëve’ i përbërë prej dy moduleve dhe kishte për qëllim transfersimin e njohurive në fushën e migrimit dhe zhvillimit. Moduli i parë është organizuar me datë 30-31 Maj 2022 ndërsa moduli i dytë është organizuar në më 15-16 Nëntor 2022.</p> <p>Ndërkohë, me projektin e sapo filluar SDC/IOM është</p>

				migrimit			paraparë të bëhet vlerësimi i nevojave dhe zhvillimi i programit 3 vjeçar të ndërtimit të kapaciteteve për antarët e Grupit Strategjik dhe Grupeve Tematike të AQM-së.
4.1.6	Zhvillimi i hulumtimeve dhe analizave të reja dhe përgatitja e rekomandimeve për institucionet përgjegjëse me qëllim të zhvillimit të politikave sektoriale duke përfshirë edhe çështjet gjinore	2021 - 2023	Donatorë MIMAK/ SDC GIZ	AQM/ MPB	3 Hulumtime dhe analiza në fushën e migrimit të zhvilluara	Profilet e Migrimit Pakti Global për Migrim	Në Shkurt 2023, APRK/AQM në bashkëpunim me GIZ/DIMAK kanë realizuar një Studim mbi ndikimin e migrimit në tregun e punës dhe mundësitë e punësimit. Aktualisht APRK/AQM dhe GIZ/DIMAK janë duke zhvilluar një hulumtim lidhur me ndikimin e emigrimit në tregun e punës me fokus në operatorët ekonomik privat. Poashtu është hartuar dhe miratuar (me datë 15 Dhjetor 2022) dhe publikuar Profili i Lehtë i Migrimit 2021, ndërsa ka filluar hartimi i Profilit të Zgjeruar të Migrimit 2018-2022.
4.1.7	Hartimi dhe publikimi i buletinit informativ lidhur me fushë-veprimtarinë dhe angazhimet e AQM-se dhe publikimin e artikujve për të promovuar politikën e migrimit dhe zhvillimit	2021 - 2023	Donatorë MIMAK/ SDC	AQM	5 Buletine informative të zhvilluara dhe publikuara	Plani i Komunikimit të AQM-së	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti.
4.2	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Avancimi i sistemit informativ për menaxhimin e migrimit (SIMM)</i>					
4.2.1	Vlerësimi i funksionalitetit të SIMM dhe adresimi i defekteve eventuale	2021	Donacion MIMAK/ SDC	AQM	Vlerësimi i dhe funksionalizimi i tërësishëm i SIMM i kryer		Është realizuar vlerësimi i funksionalitetit dhe është bërë adresimi i të gjitha mangësive të identifikuara në SIMM. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme në bazat e të dhënave të institucioneve të ndryshme po reflektohen me pengesa në funksionimin e SIMM. Prandaj, ky aktivitet do të

							mbetet të zbatohet në vazhdimësi ndërsa projekti IOM/SDC ka paraprë disa intervenime në bazat e të dhënave në fushën e migrimit të cilat do të jenë në përputhje me standardet e EUROSTAT-it.
4.2.2	Integrimi e të dhënave në fushën e migrimit në kuadër të SIMM	2021	Donacion MIMAK/SDC	AQM	Të dhënat nga fusha e arsimit dhe shëndetësisë integrohen në SIMM		Është bërë avancimi i SIMM ku baza e të dhënave në sektorin e arsimit është integruar në SIMM, ndërsa është në proces ndërlidhja me sektorin e shëndetësisë.
4.2.3	Trajnimi i anëtareve të AQM për përdorimin e SIMM	2021	Donacion MIMAK/SDC	AQM	1 Trajnim dhe çertifikim i antarëve të AQM-së për përdorimin e SIMM		Në vitin 2021 Projekti MIMAK ka organizuar trajnimin për anëtarët e AQM-së mbi përdorimin e SIMM, mirëpo për shkak të kufizimeve me pandeminë Covid-19, nuk është realizuar edhe çertifikimi.
4.3	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Avancimi i bashkëpunimit dhe partneritet shumë-palësh në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migrimit</i>					
4.3.1	Pjesëmarrja në forumet ekzistuese dhe nismat e reja rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e migrimit	2021 - 2023	BK Donacion	AQM MPB MPJD MFPT ASK	Shkëmbimi i përvojave rreth trendeve dhe iniciativave të reja në fushën e migrimit		<p>Gjatë periudhës raportuese ka pasur pjesëmarrje në këto aktivitete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Konferencë Rajonale mbi ripranimin organizuar nga MARRI 2. Intervistë për vlerësimin teknik të interpretimit në distancë për akterët kryesor nga Kosova, IOM- Projekti IPA III – BE 3. Teknikat e intervistimit, EASO 4. Konferencë 'Veprimet e Përbashkëta të Ballkanit Perëndimor kundër trafikimit me qenie njerëzore në kontekst të migrimit' organizuar nga ICPMD

						<p>5. Takimi i Zyrtarëve të Lartë në kuadër të Procesit të Pragës i mbajtur në Vjenë, Maj 2022</p> <p>6. Pjesëmarrje në takimin e projektit rajonal IKAM të ICMPD me temë 'Krijimi i platformës për informim të migrantëve'.</p> <p>7. Pjesëmarrja në 2 takime të SOM (zyrtarëve të lartë) në kuadër të Procesit të Pragës, në Tetor 2022 dhe Prill 2023.</p> <p>8. Vizitë studimore të organizuar nga EUAA në Maj 2023 në Slloveni.</p> <p>9. Lansimi i Projektit IPA III, Prill 2023 në Bruksel.</p> <p>10. Vizitë studimore në Hungari, 29-31 Maj .</p> <p>11. Pjesëmarrja në Dialogun e 3 të Migrimin në Sarajevë, organizuar më IOM, me 8-9 Qershor 2023.</p>
4.3.2	Antarësimi në organizata dhe nisma ndërkombëtare	2023	BK	MPB MPJD	Anëtarësimi në organizatat relevante: Procesin e Budapestit, Procesin e Pragës, Forumin Global për Migrim dhe Zhvillim, GDISC	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti, përveq se janë shkëmbyer disa shkresa me GDISC ku është sqaruar procedura që duhet ndjekur për aplikim. Aktualisht janë duke u zhvilluar konsultime të brendshme për të vlerësuar pastaj kohën e përshtatshme se kur do të procedohet me aplikim.
4.3.3	Fuqizimi i bashkëpunimit bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar përmes shkëmbimit të përvojave	2021 - 2023	GIZ	AQM	Së paku 3 Programe të shkëmbimit të implementuara	Me mbështetje të GIZ/DIMAK me datë 23 dhe 24 Mars 2023 është realizuar vizita studimore në Republikën e Shqipërisë, ku pjesëmarrës përveq Kosovës dhe Shqipërisë ishin edhe përfaqësues nga Serbia, Gjerogjia, Mali i Zi, etj.

	në fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së migrimit						
4.3.4	Krijimi e platformës së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave mbi lëvizjet e përziera migratore	2022 - 2023	Donatorë GIZ IOM	AQM	Platforma e krijuar për shkëmbimin e të dhënave me vendet e rajonit dhe BE-së për shkëmbimin e të dhënave lidhur me flukset e përziera të migrantëve		Në kuadër të projektit rajonal, IOM ka koordinuar procesin e krijimit të Platformës për shkëmbimin e të dhënave mbi lëvizjet e përziera migratore. Platforma si e tillë është funksionale ndërsa për menaxhimin e saj është ngarkuar MARRI e cila ka përgaditur edhe udhëzuesit praktikë për autoritetet e secilit vend për metodologjinë e futjes së të dhënave në platformë. Edhe pse platforma është funksionale, një ndër sfidat kryesore është mungesa e vazhdimësisë në futjen e të dhënave nga ana e vendeve pjesëmarrëse në këtë iniciativë.
4.4	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Menaxhimi efikas i të dhënave në fushën e migrimit</i>					
4.4.1	Ndërlidhja e Sistemit për Menaxhimin e Rasteve për riintegrim me institucionet tjera si MSH, MASHTI, MAPL, ME dhe MBPZHR	2021 - 2023	BK GIZ	MPB MASH TI MFPT MSH MBPZ HR	SMR e ndërlidhur me 5 institucionet relevante	Rregullore (QRK) për Riintegrimin e personave të riatdhesuar	Kontraktimi i operatorit ekonomik për zhvillimin dhe avancimin e SMR-së është në Planin e Prokurimit për vitin 2023.
4.4.2	Avancimi i sistemit për menaxhimin e kufirit BMS me të dhëna biometrike si dhe ndërlidhja me sistemet DSHAM	2021	BK	PK DSHA M/MP B	BMS i ndërlidhur me DSHAM	Avancimi i sistemit për menaxhimin e kufirit BMS me të dhëna biometrike si dhe ndërlidhja	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti.

						me sistemet DSHAM	
4.4.3	Avancimi i Sistemit Informativ të Vizave SIVK	2021 - 2022	BK	MPJD MPB	Plotesim-ndryshimi i UA per Leshimin e Vizave ne Misione Diplomatike dhe Konsulore; UA per leshimin e Vizave ne PKK; UA per SIVK; UA per vazhdimin e vizave të miratuara	Ligji për të Huaj Vendimi i Qeverisë (2013)	Është bërë plotësim-ndryshimi i UA për lëshimin e vizave në PKK Nr. 10/2020 dhe UA për vazhdimin e vizave Nr.09/2020.
4.5	<i>Objektivi Specifik</i>	<i>Fuqizimi i sistemit për mbrojtje ndërkombëtare</i>					
4.5.1	Vleresimi përputhmerise se sistemit vendor te azilit dhe hartimi i një Udhërrefyesi për të harmonizuar sistemin vendor te azilit me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së, përfshirë parimet e Paktit te BE-se për Migrim dhe Azil	2021 2022	GIZ	MPB	Raporti nga vleresimi i hartuar	Pakti i BE-se per Azil dhe Migracion	Është bërë vlerësimi ex-post i Ligjit për Azil. Poashtu, është nënshkruar Udhërrefyesi për bashkëpunim ndërmjet EASO dhe Kosovës 2022-2023 i cili synon forcimin e sistemit vendor të azilit dhe pritjes në përputhje me sistemin e përbashkët evropian të azilit dhe standardet e BE-se.
4.5.2	Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së informatave dhe krijimi i bazës së të dhënave mbi vendet e origjinës (IVO) për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare	2021 - 2021	BK Donacion Projekti rajonal i BE-së për Menaxhimi	MPB	Data baza funksionale dhe e shfrytëzuar për nevojat e DSHAM Sistemi i mbledhjes IVO i përmirësuar	Ligji për Azil Organo gram i	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti.

			n e Migrimit në Ballkanin Perëndimor			MPB-se (DSHAM)	
4.5.3	Rekrutimi i personelit shtesë për çështje të IVO	2021	BK	MPB	1 Zyrtarë i rekrutuar në Divizionin për Azil	Rregullorja për Funksionimin e Brendshëm të MPB-së	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti.
4.5.4	Hartimi i Udhëzuesit për trajtimin e fëmijëve aplikues për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatë dhe migrantë si dhe zhvillimin e trajnimeve përkatëse për zyrtarët e përfshirë	2021	Donacion UNICEF	MPB UNHCR	Udhëzuesi i hartuar 20 zyrtarë të trajnuar	Ligji për Azil	Udhëzuesi për vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të mirë të fëmijëve azilkërkuar, refugjatë dhe migrantë është aprovuar nga MPB. Poashtu, me mbështetjen e IOM dhe UNHCR-it janë trajnuar zyrtarët përgjegjës në DSHAM dhe Policinë e Kosovës.
4.5.5	Zhvillimi i trajnimeve të avancuara për zyrtarët lidhur me përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare (PSR)	2021 - 2022	Donacion Projekti rajonal i BE-së për Menaxhimin e Migrimit në BP	MPB UNHCR	3 zyrtarë të azilit të trajnuar në këto fusha: 1. Përfshirja në statusin e refugjatit, 2). Teknikat e intervistimit, 3). Teknikat e intervistimit të personave të cënueshëm, 4).Vlerësimi i provave Rritja e cilësisë në përcaktimin e statusit të mbrojtjes	Ligji për Azil	Zyrtarët e azilit në DSHAM janë trajnuar dhe certifikuar EUAA (Agjencia e Azilit të BE-së) në këto fusha: 1 Teknikat e intervistimit 2 Intervistimi i fëmijëve 3 Vlerësimi i provave

4.5.6	Trajnimet për Komisionin Kombëtar për Refugjatë dhe gjykatat për përcaktim të statusit të refugjatit	2021 - 2023	Donacion UNHCR	Akademia e Drejtësisë UNHCR	7 anëtare të KKR dhe 20 gjykatës të trajnuar	Ligji për Azil	Me mbështetjen e UNHCR janë mbajtur këto trajnime: 1.Me Anëtarët e Komisionit Kombëtar për Refugjatë – “Legjislacioni dhe Praktika Juridike për fushën e Azilit në Kosovë”. 2.Me Akademinë e Drejtësisë dhe Oden e Avokatëve janë mbajtur ndaras 2 trajnime me temën “Mbrojtja Nderkombëtare e Refugjatëve”.
4.5.7	Përmirësimi i qasjes në shërbimet e përkthimeve për gjuhët e huaja, gjuhët e rralla, përfshirë ofrimin e shërbimeve online	2021 - 2023	BK	MPB MPJD	Shfrytëzimi i data bazës së MARRI për përkthyesit	Ligji për Azil	Përveq kontratës aktuale të MPB-së për ofrimin e shërbimeve të përkthimit, shfrytëzohet edhe data baza e MARRI-t për përkthimet në distancë si dhe në raste të caktuara edhe shërbimet e përkthimit nga UNHCR.
4.5.8	Trajnimi i zyrtarëve të Qendrës për Azil për të drejtat dhe detyrimet në lidhje me kushtet e pranimit	2021 - 2023	Donacion UNHCR	MPB	5 zyrtarë të trajnuar	Ligji për Azil	Me mbështetjen e UNHCR është mbajtur trajnimi për mbrojtjen e femijëve azilkërkues, refugjatë dhe migrantë, respektivisht implementimin praktik të Udhëzuesit për zbatuesit e këtij të fundit. Pjesëmarrës në trajnim kanë qenë zyrtarët nga Qendra për Azil.
4.5.9	Rekrutimi i personelit shtesë për Qendrën për Azil	2021	BK	MPB	8 zyrtarë të punësuar në Qendrën për Azil	Rregullorja për Funksionimin e Brendshëm të MPB-së	Në periudhën raportuese nuk ka pasur progres në zbatimin e këtij aktiviteti.
4.5.10	Rishikimi i Planit Emergjent të brendshëm për Qendrën për Azil	2021	Donacion UNHCR	MPB	Plani i Rishikuar	Rregullorja për funksionimin të Qendrës për Azil	Plani i brendshëm emergjent për Qendrën e Azilit është finalizuar dhe është në procedurë të përshtatjes dhe aprovimit me procedurat e Agjencionit për Menaxhim Emergjent AME-së.

4.5.11	Forcimi i kapaciteteve për identifikimin e azilkerkuesve dhe sigurimin e qasjes në shërbime dhe procedurat e azilit,	2021 - 2023	BK	MPB UNHCR	Personeli i autoriteteve perkatese i trajnuar ne identifikimin e hershem te azilkerkuesve	Ligji për Azil	Qendra e Përkohshme e Pritjes është plotësisht funksionale ndërsa me projektin e SDC/IOM pritet që të vazhdohet me trajnimin e stafit përkatsisht zyrtarëve policor në aspektet e profilizimit dhe referimit të migrantëve.
4.5.12	Rishikimi dhe Përditësimi i Planit Kontigjent	2021 - 2023	BK	MPB UNHCR IOM	Plani Kontigjent i rishikuar dhe përditësuar cdo vit	Ligji për Azil	Plani për Menaxhimin e Fluksit të mundëshëm të migrantëve është në fuqi, ndërkohë rishikimi i tij planifikohet të bëhet në tremujorin e fundit të vitit 2023.
4.5.13	Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së mbrojtjes ndërkombëtare	2021 - 2023	BK	MPB UNHCR	Vleresimet vjetore te kryera, standardi i cilesise i ngritur	Ligji për Azil	Vlerësimi i cilësisë së sistemit për mbrojtje ndërkombëtare zhvillohet në vazhdimësi dhe të gjitha rekomandimet e dalura nga këto vlerësime adresohen duke ngritur kështu cilësinë e mbrojtjes ndërkombëtare.
	Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik 5.5:						
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>						
	Nga të cilat rrjedhëse:						
	Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit:						
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>						
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>						